



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-23-0143

***Në ankesën e***

***Paditësit/Ankuesit***

**E A, M B dhe N LI**, që të gjithë nga Prizreni përfaqësuar nga avokat, T B, Gjakovë dhe

**F A, I A dhe E A**, që të gjithë nga Prizreni përfaqësuar nga avokat Y K, Prizren.

***Kundër***

***E paditura***

**Fabrika farmaceutike "Farmakos" Prizren**, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr. sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Djellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve të paraqitur, ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-14-0192 të datës 27 shkurt 2023, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësve është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-III-14-0192 të datës 27 shkurt 2023.**
- 3. Padia e paditësve aprovohet se e bazuar.**

**4. Obligohet e paditura - NSH "Farmakos" në Prizren, tua njehë paditësve të drejtën e pronësisë si bashkëpronar çdo njërit prej tyre nga 1/6 pjesë ideale, për ish ngastrën nr. P-..., në vendin e quajtur "B", në sipërfaqe prej 12024 m<sup>2</sup>, ZK Prizren, e cila është shkrirë dhe është pjesë e ngastrës P-..., e cila është përkufizuar sipas përmasave dhe dimensioneve, në veri me ngastrën kadastrale ..., përkatësisht rrugën kryesore Prizren – V në gjatësi prej 64.25 m<sup>2</sup>, në jug me ngastrën kadastrale ..., në gjatësi prej 61.50 m, në lindje me ngastrën ..., në gjatësi prej 167.38 m, në perëndim me ngastrën ..., me gjatësi prej 181.71 m, në sipërfaqe totale kjo ngastër është prej 12024 m<sup>2</sup>, duke u bazuar në ekspertizën, kopjen e Planit të datës 08 dhjetor 2022 dhe skicat gjeodezike të ekspertit të gjeodezisë të datës 08 dhjetor 2022.**

**5. Nuk caktohen taksa gjyqësore lidhur me procedurën ankimore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

#### **Procedura sipas padisë pronësore në procedurën e likuidimit**

Me datë 13 korrik 2010, paditësi i ndjerë H A e ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit të NSH "Farmakos" në Prizren dhe kërkon njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrën kadastrale nr...., në sipërfaqe prej 1.20,32 ha në vendin e quajtur "B" në Prizren, evidentuar në fletën poseduese nr.... KK Prizren.

Me datë 30 shtator 2013, Autoriteti i Likuidimit me vendimin PRZ026-0143, kërkesën e paditësit për njohjen e të drejtës në pronësi për ngastrën nr.... e refuzon si të pa vlefshme me arsyetimin se paditësi nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftuara për t'ia njohur të drejtën e pronësisë lidhur me ngastrën nr.....

Autoriteti i Likuidimit konstaton se kishte dërguar një letër me datë 26 mars 2013 tek paditësi dhe kërkohet të dorëzohej dokumentacion shtesë. Paditësi me 10 prill 2013 është përgjigjur, por nuk ka paraqitur fletën poseduese për ngastrën në fjalë të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Kadastral. Autoriteti i Likuidimit konstaton se Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike në Prizren ka dëshmuar se ngastra nr.... i është bashkuar ngastrës nr.... e cila është në shfrytëzim të NSH-së "Farmakos", kjo në bazë të Regjistrimit të Ndërrimeve nr.175/92.

Me datë 01 nëntor 2013, paditësi i ndjerë H A e dorëzon një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ026-0143, të datës 30 shtator 2013, duke e kundërshtuar këtë vendim të cilin e konsideron si jo ligjor. Në këtë ankesë paditësi e përsërit pretendimin e tij se Kontrata e shitblerjes Leg.nr.... e datës 27.12.1963, e lidhur në mes të paraardhësit të tij R A dhe "KBI Progres Eksport" Prizren lidhur me ngastrën nr.... ZK Prizren në sipërfaqe prej 1.20,32 ha, është anuluar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren P.br.564/97, të datës 17.12.1997, i cili është i plotfuqishëm nga data 12.01.1998, andaj NSH-ja e paditur nuk ka asnjë bazë juridike ta mban ngastrën e cekur dhe se ai ka të drejtë ti kthehet ngastra në pronësi dhe posedim pas anulimit të kësaj kontrate.

Me datë 05 shtator 2014, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Tutje AKP-ja pohon se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe se gjykata duhet të fokusohet në shqyrtimin e këtij aspekti të ankesës. Tutje në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka kërkuar nga paditësi të ofrojë dëshmi në mbështetje të kërkesës, mirëpo ai ka dështuar të ofrojë dëshmi të cilat provojnë se ai e ka të drejtën e regjistrimit të drejtës së pronësisë për ngastrën lëndore. Tutje AKP-ja pohon se NSH "Farmakos" nuk ka hyrë në marrëdhënie juridike me paditësin, andaj asaj i mungon legjitimiteti pasiv. Me mbrojtjen në ankesë ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 02 gusht 2019, paditësi e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe kërkon që të caktohet masa e sigurimit për ngastrën lëndore.

Me datë 27 gusht 2019, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-13-2804, kërkesën për caktimin e masës së sigurisë e refuzon si të pa bazuar.

Me datë 09 shkurt 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ndërprente procedurën në këtë çështje juridike kontestimore, për shkak të vdekjes së paditësit H A nga Prishtina.

Me datë 21 shkurt 2022, avokati i paditësit e dorëzon një parashtresë në DHPGJS në të cilën si paditës i cekë A,F dhe I A, ndërsa në këtë parashtresë thuhet se E A dhe paditësit të tjerë M B dhe M LI e kanë revokuar autorizimin ndaj avokatit Y K e në procedurën në vazhdim ai pohon se do ti përfaqësoj paditësit F dhe I A, ndërsa në këtë parashtresë njofton që në ndërkohë ka vdekur edhe A A, dhe po ashtu ka vdekur edhe bashkëshortja e tij F A, dhe si trashëgimtar paraqitet i biri i tyre E A, i cili e ka autorizuar avokatin Y K ta përfaqësojë në këtë kontest gjyqësor. Bashkë me këtë parashtresë është dorëzuar autorizimi për F A, I A, si dhe certifikatat e vdekjes për A A, dhe F A, certifikata e lindjes për E A dhe autorizimi për E A.

Me datë 21 prill 2022, gjyqtari përgjegjës i lëndës në Shkallën e I-rë lëshon një urdhrë për avokatin e paditësve që në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, të njoftojë gjykatën për shqyrtimin e trashëgimisë për të ndjerin H A dhe për të vërtetuar legjitimitetin aktiv të palëve paditëse.

Me datë 30 mars 2023, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS me Aktvendimin C-IV-13-2804, kërkesëpadinë e paditësve e hedhë poshtë si të pa pranueshme, për shkak të mungesës së legjitimitetit real aktiv të paditësve. Kolegji i Shkallës së I-rë ka arsyetuar se me urdhrin e datës 21 prill 2022 janë njoftuar palët paditëse që duhet ta shqyrtojnë trashëgiminë për të ndjerin H A, të cilët e kanë pranuar urdhrin me datë 28 prill 2022, por nuk janë përgjigjur këtij urdhri, gjegjësisht nuk

kanë ofruar prova se është bërë shqyrtimi i trashëgimisë për të ndjerin H A. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se bazuar në nenin 76 të LPK-së, kërkesëpadia është hedhur poshtë për shkak se nuk është vërtetuar legjitimiteti aktiv i palëve në procedurë.

Me datë 24 prill 2023, paditësit përmes postës e kanë dorëzuar një ankesë kundër Aktvendimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-13-2804, të datës 30 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkojnë nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të priset Aktvendimi i ankimuar dhe shkresat e kësaj lëndë ti bashkohen lëndës tjetër C-III-14-0192. Për më tepër në ankesë paditësit kanë pohuar se me parashtrirat e dorëzuara në Shkallën e I-rë në lëndën C-III-14-0192, janë bashkangjitur aktvdekja e të ndjerit R A, trashëgimtarët e të cilit janë M LI, M B, F A, I A, E A dhe E A. Tutje në këtë ankesë ai pohon se në lëndën C-III-14-0192, është refuzuar kërkesëpadia e paditësve, dhe ndaj Aktgjykimit në këtë lëndë është paraqitur ankesë pranë Kolegjit të Apelit. Andaj nga këto arsye meqë zhvillohen dy lëndë paralelisht të natyrës së njëjtë me objekt të njëjtë dhe ndërmjet palëve të njëjta, i propozohet Kolegjit të Apelit që ti bashkojë këto lëndë. Bashkë me këtë ankesë ka bashkangjitur Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren P.br.nr.564/97, datë 17.12.1997, parashtrirën të cilës i referohet në ankesë në lëndën C-III-14-0192, aktvdekjen për të ndjerin R A, kopjen e Aktgjykimit C-III-14-0192, të datës 27 shkurt 2023, kopjen e ankesës të paraqitur ndaj këtij aktgjykimi, të datës 17.03.2023.

Kjo ankesë regjistrohët me numrin AC-I-23-0236.

Me datë 14 mars 2024, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-23-0236, ankesën e paditësve e refuzon si të pa bazuar dhe e vërteton Aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se paditësit nuk e kanë rregulluar çështjen e trashëgimisë lidhur me ankesën e tyre të dorëzuar në DHPGJS me 01 nëntor 2013, ndaj vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe atë në dy nivele. Paditësit e

tanishëm paraqiten se janë trashëgimtarë të ndjerit H A. Në ndërkohë përfaqësuesi i paditësve me parashtresën e tij të fundit në Shkallën e I-rë të datës 21 shkurt 2022, ka njoftuar gjykatën se ka vdekur edhe A A, dhe bashkëshortja e tij F A gjë që as për këta persona nuk është rregulluar legjitimiteti aktiv i paditësve. Tutje Kolegji i Apelit vëren se gjyqtari përgjegjës i lëndës i Kolegjit të Shkalles së I-rë të DHPGJS-së ka bërë përpjekje dhe paditëseve ju ka dhënë mundësin që të sjellin Aktvendimin e trashëgimisë dhe atë për të ndjerin H A, me urdhrin e lëshuar me datë 21 prill 2022. Paditësit kanë pasur kohë të mjaftueshme madje mbi 1 vit ta rregullojnë legjitimitetin e tyre aktiv në të dy nivelet, dhe ta sjellin Aktvendimin e trashëgimisë, por ata është e qartë se kanë dështuar të sjellin këtë dokument që është i nevojshëm, madje i domosdoshëm për të rregulluar legjitimitetin e kontestuar aktiv të tyre në procedure. Paditësit i kanë sjelle certifikatat e lindjes dhe të vdekjes dhe akt vdekjen, por me dokumente të tilla të gjendjes civile në bazë nenit 171.1 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, nuk mund të rregullohet legjitimiteti aktiv i paditësve në procedurë, ngase nuk janë deshmi të duhura në bazë të kësaj dispozite ligjore. Andaj në bazë të arsyeve të cekura, ankesa e paditësve është refuzuar si e pabazuar, dhe është vërtetuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkalles së I-rë të DHPGJS-së. Kolegji i Apelit vëren se paditësit në ankesën e tyre kanë kërkuar nga Kolegji i Apelit që të bashkohen lëndët C-III-14-0192 me lëndën C-IV-13-2804, duke pretenduar që objekti i kontestit është i njëjtë dhe palët janë të njëjta. Kolegji i Apelit e ka pasur në konsideratë këtë pretendim ankimor, mirëpo nuk ka vendosur të bashkohen këto lëndë, meqë në lëndën C-III-14-0192 është vendosur në merita të padisë, dhe Kolegji i Apelit do të vendos lidhur me ankesën AC-I-23-0143 të paraqitur ndaj Aktgjykimit refuzues në lëndën C-III-14-0192, ndërsa në lëndën C-IV-13-2804 nuk është vendosur në merita, ankesa ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit, nga shkalla e I-rë e DHPGJS-së është hedhur poshtë për shkak të mos rregullimit të legjitimitetit aktiv. Andaj nga këto arsye ankesën AC-I-23-0236 e ka trajtuar veçmas, duke qenë se ishte paraqitur veçmas ndaj Aktvendimit të shkallës së I-rë në lëndën C-IV-13-2804. Kolegji i Apelit konstaton se me këtë Aktvendim nuk po vendoset në merita të kërkesë padisë. Andaj ky Aktvendim i

kësaj lënde, në raporte me lëndën tjetër në pritje pranë Kolegjit të Apelit, AC-I-23-0143, nuk mund të konsiderohet si çështje e gjykuar në merita të padisë.

### **Padia pronësore e dorëzuar në DHPGJS**

Me datë 18 korrik 2005, paditësit H A, M LI dhe M B e dorëzuan në DHPGJS një padi dhe kërkuan nga gjykata kthimin në pronësi të ngastrës nr.... në vendin e quajtur B në Prizren, si dhe kërkuan tu kompensohet dëmi në mënyrë solidare të shkaktuar familjes A për mosshfrytëzimin e pronës kontestuese që nga viti 1997 e deri më sot. Paditësit pretendojnë se babai i tyre ka qenë pronar i pronës së paluajtshme, të ngastrës kadastrale nr...., e evidentuar në Fletën Poseduese nr. ..., e cila gjendet në vendin e quajtur B në Prizren. Ata pohuan se babai i tyre R Ai detyruar ta shesë pronën e tij, tek KBI. "Progresi", Prizren me që rast ishte lidhur Kontrata e shitblerjes Ov.br..., e datës .. dhjetor... Tutje paditësit pohuan se me 07.11.1997, babai i tyre kishte filluar procedurën për kthimin e tokës para Gjykatës komunale në Prizren. Paditësit në padi po ashtu pohuan se me datë 17 dhjetor 1997, Gjykata komunale në Prizren, me Aktgjykim, P.br.564/97, e ka shpallur të pavlefshëm Kontratën e shitblerjes, Ov. br..., ..., dhe se ata kanë të drejtë tu kthehet prona e tyre. Paditësit në padi po ashtu kanë kërkuar të caktohet masa e përkohshme dhe ti ndalohej të paditurës ta tjetërsoj, ngarkoj me hipotekë apo të ndërmerre çfarëdo veprimi lidhur me ngastrën nr. ..., deri sa të vendoset në merita të padisë.

Me datë 13 shtator 2005, me Aktvendim e Trupit gjykues të DHPGJS-së, SCC-05-0226, përcjellët padia dhe shkresat e lëndës në Gjykatën Komunale Prizren, për vendosje.

Me datë 17 maj 2011, me Aktvendimin, C.nr. 30/06 Gjykata Komunale në Prizren, e ndërpre në procedurën lidhur me padinë, për shkak se ndaj të paditurës ka filluar procedura e likuidimit. Ndërsa në piken dy (2) të diapozitivit të Aktvendimit refuzohet si e pa bazuar propozimi i paditësve për caktimin e masës së përkohshme.

Me datë 24 qershor 2011, paditësit (në tekstin e mëtejshëm: ankuesit) kanë paraqitur ankesë në DHPGJS ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr. 30/06 2005 të datës 17 maj 2011, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjen faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesit i kërkojnë DHPGJS-së, të shfuqizojë Aktvendimin mbi ndërprerjen e procedurës, si dhe si dhe paragrafin dy (2) të dispozitivit me të cilin refuzohet propozimi për caktimin e masës së përkohshme.

Me datë 24 gusht 2011, dosja e lëndës (SCC-05-0226 dhe C.nr. 30/06 2005) është dërguar në DHPGJS nga Gjykata Komunale në Prizren.

Lënda pastaj regjistrohet për Kolegjin e Apelit dhe merre numrin AC-II-12-0106.

Me datë 24 korrik 2014, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-II-12-0106 ankesën e paditësve e aprovon si të bazuar, e anulon Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.30/06 të datës 17 maj 2011, padinë e paditësve e dërgon në Kolegjin përkatës të Specializuar për vendosje, dhe vendos të cakton Urdhrin paraprak gjyqësor, si dhe e ndalon AKP-në që të shes, tjetërsoj, ngarkoj apo të bëjë çfarëdo ndryshimi në librin kadastral për ngastrën nr. ..., në sipërfaqe prej 1.20,32 ha, ZK Prizren, deri sa të vendoset në merita të padisë.

Pas anulimit të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.30/06 të datës 17 maj 2011, kjo lëndë pastaj regjistrohet në DHPGJS, për shkallën e parë, dhe merre numrin C-III-14-0192.

Pas disa seancave të mbajtura dhe parashtresave të dorëzuara nga palët, me datë 18 janar 2023 mbahet seanca e fundit dëgjimore lidhur me padinë e paditësve. Në bazë të procesverbalit të seancës vërehet se përfaqësuesit e paditësve i kanë përsëritur pohimet e tyre të cekura në parashtresat e tyre, duke e bazuar padinë në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren P.nr.564/97. Përfaqësuesi i AKP-



së ka kërkuar që Gjykata të mos e bazojë vendimin e saj në një aktgjykim i cili po të nxirrej në rrethana të rregullta padyshim do të hidhej poshtë padia. Përfaqësuesi i AKP-së ka pohuar se nga aktgjykimi prezantuar nuk shihen as data e parashtrimit të padisë për anulimin e kontratës, e që në këtë rast është e rëndësishme që të trajtohet afati i parashkrimit, nëse kjo padi ishte e rregull apo jo. Në bazë të procesverbali vërehet se palët kishin marrë përsipër që fjalën përfundimtare ta paraqesin me shkrim.

Me datë 25 janar 2023 i autorizuari i paditësve e paraqet fjalën përfundimtare në të cilën ai i përshkruar zhvillimet që kanë ndodhur në këtë lëndë, dhe mbështet edhe në ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë F B, duke pohuar se paditësit kanë të drejtë të kthehet prona mbi ngastra nr...., ZK Prizren çdonjërit prej tyre nga 1/6 të pjesës ideale, pasi që kontrata e shitblerjes ishte anuluar në bazë të Aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës.

Me datë 30 janar 2023, AKP-ja e dorëzon fjalën përfundimtare, në të cilën ajo i ka përshkruar zhvillimet prej kur NSH "Farmakos" ka hyrë në likuidim me datë 19 janar 2007. Në fjalën përfundimtare AKP-ja mbështetet në nenin 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar në bazë të cilit ajo pohon se paditësit nuk mund të kërkojnë kthimin e pronës jashtë afateve ligjore. Tutje AKP-ja pohon se Aktgjykimi i vitit 1997 është nxjerrë në rrethana jo të rregullta dhe po të ishin rrethanat normale ky Aktgjykim do të anulohet, ngase nuk e përmban datën e paraqitjes së padisë dhe nuk përmban as faktin se kush e ka përfaqësuar të paditurën. Tutje AKP-ja pohon se prona që nga viti 1963 është në emër të NSH-së dhe se ajo nuk ka mundësi të kthehet pas kësaj distance kohore më tepër se 30 vite.

Me datë 27 shkurt 2023, Kolegji i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së me Aktgjykimin C-III-14-0192, e ka refuzuar si të pa bazuar padinë e paditësve për kthimin e ngastrës kadastrale nr...., ZK Prizren, në sipërfaqe prej 1.20,24 m<sup>2</sup>. Kolegji i shkallës së I-rë ka arsyetuar se në këtë çështje juridike lidhur me pronën kontestuese me datë 26.12.1963 ishte lidhur një kontratë e shitblerjes Vr.nr... datë ..., në mes të R (A)A shitës dhe KBI Progres në Prizren si blerës, lidhur me

ngastrën nr...., në vendin e quajtur B në sipërfaqe prej 12032 m<sup>2</sup> e evidentuar në fletën poseduese nr.... ZK Prizren, e cila ngastër ishte shitur me çmimin 144.384 dinar. Sipas certifikatës të datës 18.03.2003 nr.023-405 të lëshuar nga Drejtoria për çështje pronësore juridike në Prizren, vërtetohet se prej matjeve detale të vitit 1953 të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 1958, kjo ngastër ka qenë në pronësi të R A A, ndërsa pastaj në bazë të Kontratës së cekur të shitblerjes kalon në shfrytëzim të KBI Progres në Prizren si pasuri shoqërore. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se bazuar në shënimet kompjuterike të vitit 1995, ngastra nr.... bashkohet me ngastrën nr.... e cila është në shfrytëzim të Fabrikës së barnave "Farmakos" në Prizren, në sipërfaqe prej 18.67 ari, tokë ndërtimore dhe në sipërfaqe prej 5,50.53 ha, tokë jo pjellore, dhe kjo sipas regjistrit të nderimeve nr.175/92. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se në bazë të urdhrit, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Prizrenit ka sjellë një historiat të pronës, sipas të cilës vërtetohet se në regjistrin e ndërrimeve nr.175/1992, ngastra P-..., është shkruar në ngastrën P-..., e pas shkrirjes edhe të disa ngastrave tjera në kuadër të saj, kjo ngastër ka sipërfaqe me kulturë ndërtesë prej 1867 m<sup>2</sup> dhe me kulturë tokë pjellore në sipërfaqe prej 59053 m<sup>2</sup>, e evidentuar në emër të Shoqërisë Aksionare të prodhimeve farmaceutike "Farmakos" Prizren, në emrin e së cilës evidentohet edhe sot. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se në mes të palëve mbetet kontestuese çështja e vërtetësisë së Aktgjykimit C.nr.564/97 i datës 17.12.1997, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 12 janar 1998, dhe gjykatës i është dorëzuar fotokopja e tij. E paditura gjatë seancave por e dhe në fjalën përfundimtare e ka kontestuar këtë Aktgjykim me pretendimin se në aktgjykim mungon data e ushtrimit të padisë, e cila ka të bëjë me nenin 268 të Ligjit të Punës së Bashkuar, duke pohuar se prona ka kaluar në emër të NSH-së në vitin 1963, ndërsa kanë kaluar më tepër se 30 vite dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim për kthimin e kësaj prone. Kolegji i Shkallës së I-rë konstaton se sipas paditësve e paditura ka mundur në çdo kohë të vërtetojë datën e paraqitjes së padisë dhe në këtë rast është një Aktgjykim i plotfuqishëm i gjykatës i cili prodhon pasoja juridike të favorshme për paditësin, meqë është anuluar një kontratë e shitblerjes e cila është vërtetuar se ishte lidhur nën presion për çka ka munguar vullneti i shitësit për lidhjen e saj. Tutje Kolegji i Shkallës së I-rë

konstaton se pretendimet e palës së paditur nuk do të kishin peshë, poqë se paditësit do të dorëzonin në gjykatë Aktgjykimin origjinal ose Aktgjykimin i cili është vërtetuar bazuar në origjinalin. Kjo për arsye se gjykata Aktgjykimin nuk i komenton kur ato janë të plotfuqishme, por këtu është një situatë tjetër, kur gjykata pas kundërshtimeve të paditurës ka vërejtur se Aktgjykimi i dorëzuar nga paditësit nuk është identik me kopjen e dorëzuar më herët të Aktgjykimit i cili gjendet në shkresat e lëndës. Prandaj nga këto arsye, Kolegji nuk ka mund të ia falë besimin këtij Aktgjykimi në mënyrë që paditësve t'iu bartet e drejta e pronësisë për pronën kontestuese. Kolegji i Shkallës së I-rë konstaton se përfaqësuesi i paditësve me parashtresën e datës 14.12.2022 e ka dorëzuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren P.br.546/97 të datës 14.03.1997 të përshkruar në gjuhën serbe, e në të cilën thuhet "përshkrimi i këtij Aktgjykimi nga origjinali", e të cilit pastaj i është dhënë vula e Gjykatës dhe vula e plotfuqishmërisë së vendimit. Tutje Kolegji i Shkallës së I-rë konstaton se Aktgjykimi i përshkruar në gjuhën serbe nuk ka dispozitiv të njëjtë, sikurse kopja e Aktgjykimit i cili është dorëzuar më herët, pasi që ai nuk përmban pikën e II –të të dispozitivit të Aktgjykimit të dorëzuar në kopje më herët. Në pikën e II-të të dispozitivit është vërtetuar se është tërheq padia në pjesën që ka të bëjë me dorëzimin e ngastrës nr...., fleta poseduese nr.... ZK Prizren. Gjithashtu nuk përputhet as data e nxjerrjes së Aktgjykimit e cila e mban datën 17.12.1997, tek fotokopja e Aktgjykimit, ndërsa tek përshkrimi i Aktgjykimit është data e nxjerrjes 14.03.1997. Andaj nga këto arsye ky Aktgjykim nuk ishte provë e besueshme për gjykatën, andaj nga këto arsye padia për kthimin e kësaj ngastre është refuzuar si e pa bazuar.

Me datë 10 mars 2023, avokati i paditësve E A, M B dhe N LI, av. T B e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-III-14-0192, të datës 27 shkurt 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar. Këta paditës në ankesë pretendojnë se Aktgjykimi i ankimuar e ka shkelur nenin 182.1 pika n) të LPK-së, pasi që Aktgjykimi i ankimuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të

ekzaminohet është kontradiktor, konfuz, i paqartë dhe nuk ka arsye ligjore për faktet vendimtare. Padiësit pretendojnë se ky Aktgjykim është në kundërshtim edhe me nenin 160 të LPK-së. Tutje ata pohojnë se nëse gjykata e shkallës së parë paska gjetur kundërthënie lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.564/97 të datës 17.12.1997, atëherë Kolegji i Shkallës së parë e ka pasur detyrim që ex officio të kërkojë nga Gjykata Themelore në Prizren, komplet shkresat origjinale të lëndës C.nr.564/97. Padiësit pohojnë se në këtë mënyrë ishte zgjidhur dilema dhe ishte qartësuar kontradiktoriteti eventual i pretenduar pa bazë. Tutje ata pohojnë se në cilindo modalitet të Aktgjykimit C.nr.564/97, del se është anuluar kontrata e shitblerjes Vr.nr..., e datës .. dhjetor... Tutje ata pretendojnë se nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike në këtë lëndë. Tutje ata pohojnë se komunikimi i gjykatave ishte i domosdoshëm dhe kësaj do të sanohej shkelja e nenit 182.2 pika n) e LPK-së, dhe kështu do të përmbushej detyrimi i Kolegjit të Shkallës së I-rë për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike. Padiësit pohojnë se Aktgjykimi i shkallës së parë për shkak se është i kundërligjshëm e ka traumatizuar palën padiëse.

Me datë 23 mars 2023, avokati i padiësve F A, I A dhe E A, av. Y K e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-III-14-0192, të datës 27 shkurt 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar. Në ankesë këta padiës pohojnë se Aktgjykimin origjinal nuk e kanë poseduar, andaj kjo ishte arsye që me një parashtresë ata ishin drejtuar Gjykatës Themelore në Prizren për të lëshuar kopjen e vërtetuar me origjinalin i cili gjendet në shkresat e lëndës C.nr.564/97. Gjykata në vend se të lëshojë fotokopjen e Aktgjykimit të vërtetuar nga origjinali, e lëshon Aktgjykimin e përshkruar në gjuhën serbe por gjatë përshkrimit janë përvjedhur gabimet teknike në përshkrim dhe nuk është shënuar paragrafi 2 i dispozitivit të Aktgjykimit, e gjithashtu është gabuar edhe data e nxjerrjes së Aktgjykimit pasi që datat nuk janë të ngjashme. Tutje ata pohojnë se nëse gjykata e shkallës së parë paska gjetur kundërthënie lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.564/97 të datës 17.12.1997, atëherë Kolegji

i Shkallës së parë e ka pasur detyrim që ex officio të kërkojë nga Gjykata Themelore në Prizren, komplet shkresat origjinale të lëndës C.nr.564/97. Bashkë me këtë ankesë kanë bashkangjitur një kopje të Aktgjykimit P.br.564/97, e datës 17.12.1997, në të cilën është dhënë nënshkrimi i Administratores së Gjykatës, se ky përshkrim i Aktgjykimit është në pajtim me origjinalin.

Me datë 23 tetor 2023, ankuesi i parë E A e dorëzon një parashtresë në DHPGJS, e cila në bazë të përmbajtjes së saj ka karakter të ankesës. Në këtë parashtresë ky ankues pohon se gjykata pas mbajtjes së seancës dëgjimore është dashur të kërkojë nga Gjykata Themelore në Prizren dokumentet e nevojshme, e nëse ka pasur hezitime ti sqaroj ato, dhe të mos merr aktgjykim i cili është kthyer në zhgënjim për paditësit.

Me datë 20 shkurt 2024, Kolegji i Apelit lëshon urdhër për Gjykatën Themelore në Prizren, me të cilën asaj i kërkohet që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrorit të dërgojë në DHPGJS dosjen origjinale të ish Gjykatës Komunale në Prizren C.nr.564/97.

Me datë 11 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në dy ankesat e paditësve. Në këtë parashtresë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditësve duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe e mbështet Aktgjykimin e ankimuar duke e konsideruar si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se argumentet e paraqitura gjatë mbrojtjes në padi janë të qarta dhe ato mbështeten edhe më tutje, ndërsa përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Nga këto arsye AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa e paditësve si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 01 mars 2024, Gjykata Themelore në Prizren me parashtresën nr. C.nr.564/97 të datës 28.02.2024, e dërgon në DHPGJS dosjen e kërkuar C.nr.564/97.

### **Arsyet ligjore**

Ankesa e paditësve është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë e Privatizimit, Kolegji i Apelit vendosi që të mos e mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Kolegjit të shkallës së I-rë nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të ndryshohet dhe të aprovohet padia e paditësve si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi padinë e tij pronësore për ish ngastrën nr. ... e mbështet në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren P.br.564/97, të datës 17.12.1997, i cili Aktgjykim e ka klauzolën e plotfuqishmërisë me datë 12.01.1998.

Me këtë Aktgjykim me paragrafin e parë të dispozitivit ishte anuluar Kontrata e shitblerjes Ov.br... të datës., e cila ishte lidhur në mes të paraardhësit të paditëseve të ndjerit R A A, dhe NSH KBI "Progres" Prizren. Me paragrafin e dytë të dispozitivit përcaktohet se padia është tërhequr për dorëzimin e ngastrës nr. ..., evidentuar në fletën poseduese nr... ZK Prizren.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me padinë e tij të dorëzuar në DHPGJS më herët në vitin 2005 e kishte dorëzuar një kopje të Aktgjykimit P.br. 564/97, të datës 17.12.1997, i cili ka klauzolë të plotfuqishmërisë me datë 12.01.1998. Kjo kopje nuk ka qenë e vërtetuar.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se avokati i paditësve me parashtresën e dorëzuar në DHPGJS me 14 dhjetor 2022, e dorëzon një kopje të Aktgjykimit të përshkruar në gjuhën serbe, P.br.564/97 datë 14.03.1997. Në këtë kopje është një vulë e

plotfuqishmërisë që mban datën 12.01.1998, por që vula e vendosur në këtë Aktgjykim përshkrues, është e Republikës së Kosovës, përkatësisht e Gjykatës Themelore në Prizren.

Siç ka konstatuar saktë Kolegji i shkallës së parë, kopja e Aktgjykimit P.br.564/97 nuk përputhet në plotëni me Aktgjykimin e përshkruar në gjuhën serbe P.br.564/97 e cila dërgohet më vonë në gjykatë me parashtresën e datës 14 dhjetor 2022. Kjo pasi që në kopjen e përshkruar në gjuhën serbe, mungon paragrafi i dytë i dispozitivit, që përcakton se padia është tërhequr për dorëzimin e ngastrës nr...., sipas fletës poseduese nr... ZK Prizren, e po ashtu edhe data e lëshimit në Aktgjykimin e përshkruar është 14.III.1997, ndërsa data e lëshimit në fotokopjen e Aktgjykimit është 17.12.1997, që është e qartë se ka dallim edhe lidhur me datën e lëshimit të tij.

Kolegji i Apelit vëren se Kolegji i Shkallës së parë i ka pasur dyshimet e tij lidhur me vërtetësinë e Aktgjykimit, andaj kjo ishte arsyeja kryesore në bazë të së cilës këtij Aktgjykimi të bashkangjitur, nuk i është falur besimi, dhe kjo provë nuk është konsideruar si provë valide për të aprovuar padinë, dhe për të bërë kthimin e pronës të kërkuar me padinë e paditësve.

Kolegji i Apelit vëren se përkundër këtyre dyshimeve, Kolegji i Shkallës së I-rë ka dështuar të lëshojë një urdhër për Gjykatën Themelore në Prizren, dhe të kërkojë nga kjo gjykatë dosjen origjinale të lëndës P.br. 564/97.

Në këtë situatë të krijuar, Kolegji i Apelit konsideron se Kolegji i shkallës së parë gabimisht e ka refuzuar padinë pronësore të paditësve, vetëm për faktin që ka pasur dyshime në vërtetësinë e Aktgjykimit, në bazë të cilit paditësit e mbështetin padinë.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësit me ankesën në shkallën e dytë e kanë dorëzuar një Aktgjykim përshkrues në gjuhën serbe, P.br.564/97 të datës 17.12.1997, i cili ka vulën e plotfuqishmërisë me datë 12.01.1998, ndërsa vula

është e Gjykatës Themelore në Prizren, dhe kjo kopje e Aktgjykimit përshkrues është e nënshkruar nga Administratorja e kësaj gjykate.

Kolegji i Apelit vëren se Aktgjykimi përshkrues në gjuhën serbe i cili është sjellë në procedurën ankimore, tashmë është identik me kopjen e Aktgjykimit të cilën paditësit e kishin sjellë më herët me padinë e tyre të dorëzuar në gjykatë në vitin 2005.

Për të evituar çdo dilemë lidhur me vërtetësinë e Aktgjykimit, Kolegji i Apelit ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prizren të dërgon dosjen origjinale të lëndës C.nr.564/97. Kjo gjykatë me parashtrësën e saj të datës 28 shkurt 2024, e dërgon këtë dosje në DHPGJS, dhe i bashkëngjitet kësaj lënde.

Pas shqyrtimit të kësaj dosje, vërehet se në të ekziston Aktgjykimi origjinal P.br. 564/97 i datës 17.12.1997, i cili është i pajisur me vulën e plotfuqishmërisë me datë 12.01.1998.

Pas vërtetimit të kësaj gjendje faktike lidhur me origjinalitetin e Aktgjykimit P.br.564/97 të datës 17.12.1997, Kolegji i Apelit nxjerrë konstatimin se paditësit tashmë e kanë një Aktgjykim të formës së prerë, i cili vërteton se është anuluar Kontrata e shitblerjes Ov.br.... e datës....

Tutje në bazë të këtij Aktgjykimi vërehet se paditësit në atë kohë në vitin 1997 e kanë tërhequr padinë për kthimin e ngastrës nr. ... evidentuar në fletën poseduese nr... ZK Prizren. Në arsyetimin e Aktgjykimit, nuk vërehet ndonjë arsye e tërheqjes së padisë, përkatësisht ish Gjykata Komunale në Prizren, pikën e dytë të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, fare nuk e arsyeton.

Paditësit me datën 18 korrik 2005, kanë ndërruar mendjen, dhe ata kanë vendosur të paraqesin padi të re për kthimin e ngastrës nr.P-..., në vendin e quajtur B në sipërfaqe prej 12032 m<sup>2</sup>.



Ata po ashtu kanë paraqitur padi me kërkesë të njëjtë edhe tek Autoriteti i Likuidimit, i cili e ka refuzuar kërkesën, pastaj paditësit kanë paraqitur ankesë ndaj këtij vendimi, e cila ankesë është hedhë poshtë si e papranueshme me Aktvendimin, C-IV-13-2804 të datës 30 mars 2023. Paditësit pastaj me datë 24 prill 2023 kanë paraqitur ankesë ndaj Aktvendimit, C-IV-13-2804 të datës 30 mars 2023, dhe ankesa ndaj këtij Aktvendimi është refuzuar nga Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-23-0236 të datës 14 mars 2024.

Kolegji i Apelit konstaton se tërheqja e padisë për ngastrën lëndore që ka ndodhur në vitin 1997, nuk mund të paraqesë ndonjë pengesë ligjore që ata përsëri me padi të re ta kërkojnë kthimin e kësaj prone, siç ata e kanë vepruar me padinë e dorëzuar në DHPGJS me 18 korrik 2005. Sipas nenit 261 paragrafi 5 të LPK-së, “Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri”.

Kolegji i Apelit vëren se në bazë të historiatit të pronës të cilën Shkalla e I-rë e kishte kërkuar me urdhrin e datës 17.11.2022, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër me shkresën e saj nr. 07-463/04-165591 të datës 17.11.2022, konfirmon se ngastra P-..., të cilën e kërkojë paditësit me padi, në bazë të regjistrit të ndërrimeve nr.175/1992, është shkrirë në kuadër të ngastrës P-... ZK Prizren, dhe e cila tash evidentohet emër të Fabrikës së Prodhimeve Farmaceutike “Farmakos” Prizren.

Kolegji i Apelit vëren se paditësit me parashtresën e tyre për precizimin e kërkesëpadisë në kuptimin subjektiv, të dorëzuar në DHPGJS me 14.12.2022 përveç provave tjera që ishin sjellë edhe më herët, ata kanë sjellë edhe një ekspertizë të ekspertit të gjeodezisë, gjeodetit të licencuar F B, e cila mban datë 08.12.2022.

Në këtë ekspertizë po ashtu konfirmohet se ngastra P-...-0 e cila ka pas sipërfaqe prej 12024 m<sup>2</sup>, tash është pjesë e ngastrës P-... ZK Prizren, dhe kufizohet si vijon: në veri me ngastrën kadastrale ..., përkatësisht rrugën kryesore Prizren – V

në gjatësi prej 64.25 m<sup>2</sup>, në jug me ngastrën kadastrale ..., në gjatësi prej 61.50 m, në lindje me ngastrën ..., në gjatësi prej 167.38 m, në perëndim me ngastrën ..., me gjatësi prej 181.71 m, në sipërfaqe totale kjo ngastër është prej 12024 m<sup>2</sup>, si dhe në të nuk ka të mbjella shumëvjeçare, shfrytëzohet si sipërfaqe e lirë. Bashkë me këtë ekspertizë janë dorëzuar skica po ashtu harta kadastrale 1/1000, viti 1984, harta kadastrale 1/2500, viti 1956, ortofoto aktuale, viti 2018.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se ish ngastra nr.... e cila tani është e shkrirë në ngastrën P-..., nuk është më në emër të NSH KBI "Progres" në Prizren, e cila ishte palë e kontratës së anuluar të shitblerjes, por kjo ish ngastër në bazë të Aktvendimit të Drejtorisë për punë pasurore - juridike të Komunës së Prizrenit Nr.03/3 - 465 - 12, të datës 14.12.1979, bartet në shfrytëzim tek Fabrika e barnave "Farmakos" në Prizren.

Edhe në bazë historiatit kadastral, kjo ish ngastër e cila përfshihet në ngastrën P-... ZK Prizren, vërtetohet se në regjistrin kadastral evidentohet në emër të Shoqërisë Aksionare të Prodhimeve Farmaceutike "Farmakos" Prizren. Ky subjekt nuk ishte palë e kontratës së anuluar të shitblerjes, dhe me këtë subjekt paraardhësi i ndjerë i paditësve R A A, nuk ka qenë i përfshirë në raporte kontraktuale lidhur me pronën lëndore.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se paditësit me padinë e tyre të dorëzuar me 18 korrik 2005, si palë të paditura i ka përfshirë NSH-në KBI "Progres export", Prizren dhe NSH-në Fabrikën e Barnave "Farmakos" në Prizren. Në bazë të shkresave të dosjes në shkallën e I-rë, të dyja këto ndërmarrje gjatë gjithë procedurës kanë qenë palë të paditura, të cilat i ka përfaqësuar AKP-ja, si përfaqësuese ligjore e tyre.

Kolegji i Apelit mund të konstatojë se paditësit tashmë e kanë një titull pronësor, një Aktgjykim të plotfuqishëm i cili është vërtetuar se është origjinal, mirëpo ish ngastra të cilën ata e kërkojnë me padi, nr....-0, ZK Prizren nuk është më në emër të NSH-së KBI "Progres" Prizren, por në emër të Fabrikës të prodhimeve

farmaceutike "Farmakos" Prizren, e cila është nën autoritetin administrativ menagjues të AKP-së, e cila në fakte e ka përfaqësuar edhe këtë ndërmarrje në procedurë.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se në bazë të Aktvendimit të Drejtorisë për punë pasurore - juridike të Komunës së Prizrenit Nr.03/3 - 465 - 12, të datës 14.12.1979, ngastra nr. ... që është objekt i padisë, dhe disa ngastra tjera eksproprijohen dhe barten në shfrytëzim tek Fabrika e barnave "Farmakos" në Prizren, me qëllim të ndërtimit të një Fabrike për nevoja të kësaj ndërmarrje.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se në bazë të ekspertizës gjeodezike të ekspertit të gjeodezisë F B, e cila ekspertizë është dorëzuar nga paditësit me parashtrësën e tyre të datës 14 dhjetor 2022, pjesa e ngastrës ..., përkatësisht ish ngastra ...-0 e shfrytëzohet ende paditësit, nuk ka të mbjella shumëvjeçare dhe shfrytëzohet si sipërfaqe e lirë.

Në bazë të kësaj ekspertize del që nuk është realizuar qëllimi i eksproprijimit i përcaktuar me Aktvendimin e Drejtorisë për Punës Pasurore-Juridike KK Prizren, nr.03/3-465-12, të datës 14 dhjetor 1979, përkatësisht nuk është ndërtuar fabrika për shkak të cilës ishte kërkuar eksproprijimi i ngastrës lëndore, nga ana e NSH Fabrika e barnave "Farmakos" në Prizren.

Kolegji i Apelit konstaton se paditësit tashmë e kanë një Aktgjykim të formës së prerë që vërteton se ishte anuluar Kontrata e shitblerjes Ov.br..., të datës .. dhjetor..., lidhur me ngastrën lëndore.

Kolegji i Apelit po ashtu konstaton faktin se për ngastrën lëndore nuk është realizuar qëllimi i eksproprijimit, përkatësisht qëllimi i bartjes në shfrytëzim tek Fabrika e barnave "Farmakos" në Prizren të kësaj ngastre.

Andaj duke marrë për bazë këtë fakt dhe faktin tjetër se gjatë tërë procedurës pranë Shkallës së I-rë si palë e paditur ka qenë edhe Fabrika farmaceutike

“Farmakos” në Prizren, e cila përfaqësohej nga AKP-ja, Kolegji i Apelit nxjerrë konstatimin se paditësit kanë të drejtë tu kthehet ish ngastra nr.... e cila aktualisht është e shkrirë në kuadër të ngastrës nr...., meqë ata e kanë një titull të vlefshëm pronësor një Aktgjykim të formës së prerë, me të cilën ishte anuluar kontrata lëndore e shitblerjes. Ky Aktgjykim bazuar në nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore të vitit 1980, është bazë ligjore, që paditësve tu kthehet e drejta e pronësisë për ngastrën lëndore të padisë.

Kolegji i Apelit nuk e sheh si pengesë ligjore tu njihet paditësve e drejta e pronësisë për ish ngastrën nr...., që ishte objekt i Kontratës së shitblerjes, për faktin se kjo ish ngastër tashmë është në emër të Fabrikës së barnave “Farmakos” në Prizren, që nuk ishte nënshkruese e kontratës lëndore të shitblerjes, mirëpo është e qartë se nuk është realizuar qëllimi i eksproprijimit. Bartja në shfrytëzim të kësaj ngastre tek Fabrika e barnave “Farmakos” në Prizren ishte bërë për qëllim të ndërtimit të një fabrike për nevojat e kësaj ndërmarrjeje, por që kjo nuk ka ndodhur, andaj paditësit bazuar në këtë Aktgjykim të plotfuqishëm kanë të drejtë tu kthehet në bashkëpronësi në pjesë ideale në 1/6, ish ngastra nr...., dhe atë sipas dimensioneve dhe përkufizimeve të cilat i ka dhënë eksperti i gjeodezisë në ekspertizën e tij të datës 08 dhjetor 2022, dhe e cila ish ngastër në bazë të historikut kadastral dhe ekspertizës gjeodezike është në kuadër të ngastrës P-....

Duke u bazuar në këto arsye, Kolegji i Apelit vendos që të aprovon ankesën e paditësve si të bazuar, ta ndryshon Aktgjykimin e ankimuar dhe ta aprovon padinë e paditësve si të bazuar.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

**Taksat gjyqësore**

Paditësit tashmë e kanë paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 03 maj 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga kolegji i Apelit i DHPGJS, më 18 prill 2024.

Mr. sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_